



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Duke u bazuar në nenin 12, 17 dhe 24, të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në (Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dispozitave të Ligjit Nr-03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008", nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën, 25.06.2026 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për Komunën e Dragashit për vitin 2027-2029

Neni 1

Me këtë vendim miratohet korniza afatmesme-buxhetore për Komunën e Dragashit për vitin 2027-2029 (KAB-it) dhe zhvillimi i diskutimit publik për këtë dokument zhvillomoro-buxhetor.

Neni 2

2.1 Pjesë përbërëse e këtij vendim është drafti i kornizës afatmesme buxhetore 2027-2029 dhe lista e shpenzimeve kapitale për vitin 2027 - 2029, dhe diskutimi publik do të zgjat deri në muajin shtator 2026.
2.2 Teksti i Draftit të KAB-it është transparent në web faqen e komunës Dragash (linku "Shpalljet" – konsultime publike. Në email-adresën burim.aliu@rks-gov.net, ku mund të adresohen vërejtjet apo plotësimet eventuale gjatë fazës së Diskutimit Publik.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Ekonomi, Financa e Zhvillim në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit të komunës-së dhe Kryetarin e Komunës.

Neni 4

Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024" dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01-Nr. 060/01-M872-1/26

Datë 25.06.2026



Kryesuesi i Kuvendit

Resul Fetahu
Resul Fetahu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Kuvendi Komunal Dragash
Skupstina Opstina Dragas
Municipal Assembly Dragash

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2027 - 2029

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Dragashit, është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2027-2029, të dhëna nga MFPT (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve) përmes Qarkores buxhetore 2027/01 për Komunitet si dhe financimi nga grantet ndërqeveritare dhe kufijtë fillestar të buxhetit komunal për vitin 2027 dhe parashikimet për 2028-2029. Ky dokument i ka kushtuar rëndësitë të veqante alokimit të buxhetit nga aspekti i barazisë gjinore. Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore – Komunale, do të paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve duke u bazuar në komponente barazisë gjinore duke marrë për bazë nevojat e grave dhe burave gjatë planifikimit nga aspektet e punësimit, përfituesve të bursave , participimin në vendimarrje në projekte të ndryshme, kultura, subvencionet, pjesëmarrje në degjime publike etj të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Dragashit, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush dhe përkrah projektet me prioritet, duke promovuar rritjen e mirëqenies sociale dhe familjare me fokus të veqnte në grupet në nevojë dhe barazisë gjinore që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2027-2029 gjithnjë duke u bazuar në :

- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
- Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

Në kuadër të avancimit të politikave gjithëpërfshirëse, kjo Kornizë merr në konsideratë edhe parimet dhe kërkesat e Ligjit Nr. **06/L-084** për Mbrojtjen e Fëmijës, duke synuar që planifikimi buxhetor të kontribuojë në mbrojtjen, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve, si pjesë integrale e politikave sociale dhe zhvillimore të komunës.

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantojmë është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike duke marrë për bazë nevojat grave dhe burrave dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2026-2028 të lëshuara nga Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Në këtë kontekst, KAB gjithashtu reflekton nevojën për integrimin e çështjeve që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, duke marrë parasysh se shërbimet publike në nivel lokal veçanërisht në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien dhe zhvillimin e tyre. Përmes planifikimit të qëndrueshëm buxhetor, synohet që këto shërbime të jenë të qasshme, cilësore dhe të orientuara drejt nevojave reale të fëmijëve. Për më tepër, duke u mbështetur në qasjen e buxhetimit të ndjeshëm ndaj fëmijëve, Komuna synon që në procesin e planifikimit afatmesëm të identifikojë dhe adresojë në mënyrë më të strukturuar nevojat e fëmijëve, veçanërisht atyre në situata të ndjeshme, duke siguruar që politikat dhe programet komunale të kontribuojnë në mbrojtjen dhe përfshirjen e tyre sociale.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2027-2029. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



Deklarata e Prioriteteve Afatmesme 2027-2029 nga Strategjia Zhvillimore Komunale

Komuna Dragash gjendet në pjesën jugore të Kosovës, rajoni i Prizrenit. Është njëra nga komunat me pak e zhvilluar të vendit. Pozita gjeografike që ka, i mundëson kësaj lidhje jo të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit, sepse lidhet me një drejtim. Komuna Dragashit ka gjithsej 36 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2024, Komuna ka 28,896 banorë të organizuar në 6,219 ekonomi familjare .

Ka,835 biznese që operojnë brenda komunës. Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën Dragashit, afërsisht 2/3 e tyre merren me veprimtari tregtare, 5% në sektorin e shërbimeve, afërsisht 20% në prodhimtari të ndryshme, pjesa tjetër në transport. Ku sipas statistikave nga regjistri i pronarëve të bizneseve Biznese individuale janë të regjistruar sipas gjinis burra 658 ndërsa gra 87 ndërsa Biznesi SH.P.K janë të regjistruar sipas gjinis burra 70 ndërsa gra 17 ndërsa Biznesi Ortakri e Përgjithshme janë të regjistruar sipas gjinis burra 2 ndërsa gra 1.

Administrata e Komunës së Dragashit në aspektin e administrimit është e organizuar në qënder dhe përmes zyrave lokale që ofrojnë shërbime për komunitetin sa i përket gjendjes civile, nga të cilat, një është brenda ndërtesës komunale të qytetit duke përfshirë zyrën qendrore dhe 4 të tilla në fshatra. Puntor në Administratën komunale, Shendetsi dhe Arsimi parashkollor,fillor dhe të mesem sipas gjinis burra janë 550 ndërsa gra janë 142.

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Dragashit i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në komunë, bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna sic janë: në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2027-2029 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si Qarkoret Buxhetore Komunale 2027 (I & II) të lëshuar nga Ministria e Financave,Punes dhe Transfereve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Planit zhillimor të Komues se Dragashit.

Për tri vitet e ardhshme, Vizioni i Komunës së Dragashit është të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm dhe shërbime efikase e kualitative, i integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrimt të një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attributeve binjake prioritete strategjike të komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për komunën.

Katër nga këto prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave jashtë, ndërsa një prej tyre është i brendshëm dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Dragashit:

Prioritet e Komunës

1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi të barabarta për të gjithë

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirësimin e kushtve në arsimin fillor dhe atë të mesëm)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë përmes subvencionimit të grave dhe burrave fermerë.

2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile me theks të vecante të gratë dhe grupet në nevojë
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i tereneve të reja sportive për vajza dhe djem.

3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

Në baze të hulumtimit të nevojave të grave dhe burrave Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimi të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi të standardeve të ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara
- Ofrimi i mundësive për pjesëmarrje aktive të grave dhe grupeve në nevojë;

4. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve dhe nevojave të grave dhe burrave.

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke e fokusuar qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyreve komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve për gratë dhe burrat

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2027-2029 do të shoqërohen me një laramani të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

Korniza Fiskale Komunale

Ndonëse komuna nuk udhëheq drejtëpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2027-2029 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike siç janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2027-2029 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përket edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë të grave dhe burrave në komunë, që në periudhën afatmesme pritet të ulet, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative**. Komunitat po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Dragashit në periudhën afatmesme buxhetore 2027-2029 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

❖ OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2027-2029 planifikohet në bazë të Buxhetit i cili bazohet në “Buxhetin e Programeve” dhe është i orientuar në objektivat dhe në deklarata të Misionit të Programeve . KAB 2027-2029 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2027/01 e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve. Është pjesë përbërëse e KASH-it të Republikës së Kosovës. Karakteristikë tjetër e buxhetit të tashëm është përfshirja e “Kornizës afatmesme të shpenzimeve”. Kjo na ka mundësuar që të planifikojmë të hyrat dhe shpenzimet jo vetëm për vitin pasus, por edhe për dy vite të ardhshme. Ajo që tani na duhet është definimi i “ Misionit tonë” së paku për tri vitet tjera të kthyer në objektiva, programe, veprime dhe shifra.

❖ Objektivat e Komunës së Dragashit:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit
- Zhvillimi i sferës së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale
- Ngritja e nivelit të arsimit dhe edukimit sipas KAB 2027-2029 të komunes Dragashit janë parapar këto pozita në sektorin e Arsimit si ne tabelen e me poshtme

	Numri i mesimdhensve parafillor	Numri i mesimdhensve parafillor në pushimin mjeksor dhe të lehon	Numri i mesimdhensve fillor	Numri i mesimdhensve fillor në pushimin mjeksor dhe të lehonis	Numri i mesimdhensve ne shkollen e mesme	Numri i mesimdhensve mesme në pushimin mjeksor dhe të lehonis	Mesimdhens për zona malire	Mesimdhens të gjuhes angleze	Numri i mrsimdhenseve të gjuhes së dyt	Numri i kordinatorve te cilis	Asistent me nevoja te veqanta	Asistent per nxenes në arsimin parauniversitar	Numri i kshilltareve te karieres 6-9	Numri i edukatoreve 4-5	Numri i përsoneleit administrativ për qerdhe dhe sh. Fillore	Numri i përsoneleit administrativ për sh. të mesme	Shërbimi Profesional Pedagogjik/ Psikologjik	Numri i përsoneleit ndihmës për nxënës	Numri i specialisteve të IT-së	Numri i këshilltarëve të karrierës	Total
Numri	18	3	126	15	54	3	182	21	8	15	5	6	1	12	19	2	6	49	1	6	552

- Zhvillimi i sferës së kulturës, sportit dhe rinisë.
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme
- Zhvillimi i turizmit malor
- Rritja e numrit të grave të punësuar në drejtorinë e arsimit në Dragash gjatë viteve 2027-2029 për 15%
 - Rritja e përqindjes së femrave të punësuar në drejtorinë e arsimit nga 21% aktuale në 30% përgjatë viteve 2027-2029;
 - Funksionalizimi i kopshtit komunal për të ofruar qasje më të mirë në arsim për fëmijët dhe përmirësimin e mundësive të punësimit për gratë;
 - Hapja e dy qendrave dhe 4 vende të reja me bazë në komunitet për të ofruar mundësi arsimimi dhe punësimi për gratë në komunitet;
 - Punësimi i një psikologeje për ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe këshilluese për gratë punonjëse në drejtorinë arsimore

❖ **Objektivat shtetërore:**

- Përkrahjes dhe krijimit të parakushteve për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik; rritja e numrit të grave përfituese e subvencioneve komunale për 21% me vlere (te shtohet vlere) ne raport me 2026 (të ceket sa ka qene vlere e subvencioneve që i kane përfituar grat).
- Qeverisjes së mirë dhe fuqizimit të sundimit të ligjit; Rritja e numrit të grave të punësuar për 21% deri 50% në raport me vitin 2026. (në kushte barabarta perparsi për gra) (këtu të shtohet % ekzistuese te punësuarve femra dhe meshkuj për vitin 2026)
- Zhvillimit të kapitalit njerëzor; si dhe potencialin gjithëanshem të grave dhe burrave. Rritja e numrit te përfituesve të bursave studentore për 50% femra meshkuj ne raport me vitin 2026. (këtu të shtohet 50% e përfituesve femra dhe meshkuj)
- Rritjes së mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Mbeshtetja financiare për strehimoren e grave (vazhdimi i marveshjes memorandum mirekuptimi)
- Mbështetje lehonave

Siç mund të shihet objektivat e komunës janë të lidhura ngusht me objektivat e Shtetit të Kosovës

Ky dokument ka përqëllim:

- Promovon disiplinën fiskale dhe të prezanton vlerësime reale mbi nivelin e të hyrave buxhetore.
- Prezanton politikat fiskale në funksion të implementimit të politikave prioritare të qeverisë.
- Siguron një ambient të qëndrueshëm makroekonomik, në funksion të zhvillimit të sektorit privat.
- Përcakton kufijtë e shpenzimeve me qëllim që të sigurojë nivel të ulët të deficitit fiskal.

Objektivat:

a).Shtimi i efikasitetit gjatë operacioneve

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur
- Përzgjedhja e punëve më prioritet për realizim

b). Rritja e shpejtë e të ardhurave

- Rritja e efikasitetit në inkasim
- Zgjerimi i bazës tatimore

c).Kontrolli i shpenzimeve dhe reduktimi i shpenzimeve

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë
- Përparësia nga blerja me shumicë
- Përmirësimi i specifikimit për mallra dhe shërbime
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat me afat të gjatë

d). Zhvillimi i aftësive

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore
- Përdorimi i gjerë i kompjuterit
- Profesionalizimi i shërbimeve

e). Të sigurohet disiplina financiare

- Pajtueshmëria me politikën financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet
- Ekzistenca e kontroleve interne – Auditori i Brendshëm
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik
- Analizat të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve
- Realizimi i Buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (Cash Plani)

f).Ekonomia

- Zhvillimi i strategjisë komunale për promovim ekonomik
- Krijimi i kushteve për investime të huaja
- Strategjia për zhvillimin rural

Programet

a. Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparenca

- Përmirësimi i politikës së prokurimit dhe procedurat
- Shënimet e duhura financiare dhe procedurat e kontabilitetit
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës
- Koordinimet në mes departamenteve
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat gjenerimi i statistikave gjinore
- Menaxhimi i bazës së të dhënave dhe përhapja e informative

b. Përmirësimi i bazës së të ardhurave

- Arkëtim më të madh të tarifave dhe ngarkesave që janë për t'u paguar
- Sa më shumë tatimpagues në rrjetin e tatimeve
- Çmime (ngarkesa) të ndryshme
- Ngarkesa të reduktuara

c. Ristrukturimi organizativ

- Shqyrtimi i strukturës organizative **Organogrami i Ri**

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat

- Zbatimi i rregulloreve komunale
- Shqyrtimi i planit të punës 2026
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës 2027
- Përgatitja e Kornizës së shpenzimeve afatmesme 2027-2028
- Shqyrtimi i përgjegjësisë dhe i obligimeve komunale
- Menaxhimi i projekteve
- Menaxhimi i bazës së të dhënave
- Monitorimi
- Vlerësimi

Udhëzimet kryesore nga Ministria e Financave janë:

- (a) **LIMITET** e granteve që do t'i caktojë Qeveria Qendrore për Komuna
- (b) Buxheti duhet të jetë I BALANCUAR. Kjo do të thotë se Komuna **NUK MUND** të bëjë planin për shpenzime e cilat e kalon grandet e lejuara dhe nuk mund të përgatit buxhetin deficitar.

Perspektiva e politikave fiskale

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale (politikës së të ardhurave si nga grandit i qeverisë, të hyrave vetjake komunale si dhe shpenzimeve. Me kornizën afatmesme të shpenzimeve 2027-2029 është parapare ndërmarrja e një varg masash duke filluar nga kursimet në kategorinë e shpenzimeve publike si rezultat i rekomandimeve FMN-së e deri të marrja e masave konkrete në realizimin e të hyrave në nivel qendror dhe lokal.

- Kontroll më i ngushtë dhe mbledhje e detyrueshme për ngarkesat dhe tarifatat e mbledhura në nivel lokal.
- Sensibilizimi i qytetarëve për të kryer obligimet ndaj komunës

Korniza makroekonomike e Komunës është sipas Qarkores nr. 2027/01 për Komuna

Korniza Afatmesme Makroekonomike e Komunës sonë është në përputhje me Kornizën Afatmesme Makroekonomike të Kosovës dhe dokumenteve që dalin nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH). Në përgjithësi mund të thuhet se fondet nga Grandi Qeveritar dhe Të Hyrat Vetanake Komunale për momentin nuk paraqesin potencial të mjaftueshëm financiar për zhvillimin e komunës, meqë nga të hyrat e përgjithshme nuk janë të mjaftueshme duke u bazuar në kërkesat sipas Drejtorive të Komunës sonë.

**BUXHETI NGA GRANTI DHE TË HYRAT VETANAKE PËR VITIN 2027-2029 SIPAS
QARKORES BUXHETORE NR.2027/01**

Organizata buxhetore	Aprovimi	Planifikimi	% e rritjes së buxhetit	Diferenca 2026-2027	Projeksioni	Projeksioni
	2026	2027			2028	2029
Administrata e përgjithshme	7,272,043	8,689,544	119	1,417,501	8,550,051	9,218,480
Arsimi	3,766,347	2,983,845	79	-782,502	3,073,361	3,165,561
Shëndetsia	1,626,763	1,778,228	109	151,465	1,831,575	1,886,522
Financimi për shërbimet rezidenciale						250,000
Grantet	12,665,153	13,451,617	106	786,464	13,454,987	14,520,563
Te hyrat vetanake	589,728	591,853	100	2,125	606,119	627,217
Totali:	13,254,881	14,043,470	106	788,589	14,061,106	15,147,780

Në bazë të ecurive nga viti paraprak, grantet qeveritare për Komunën e Dragashit si tërësi do të shënojnë rritje të lehtë përmes rritjes së Grantit të përgjithshëm, Shëndetsis. Rritja e granteve qeveritare do të jetë përafërsisht 6% në krahasim me vitin 2026. Sipas të dhënave të prezantuara në tabelën më lartë, kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për ndryshimet buxhetore që planifikohen në nivel të Qeverisë nacionale, siç parashihet me KASH-in 2027-2029. Rritja kryesisht është reflektuar në Grantin e përgjithshëm dhe atë të Shëndetsis (si në tabelën lartë)

Parashikimi i të hyrave vetanake komunale


Të hyrat komunale të komunës sonë realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë, të cilat të hyra duhet shpenzuar dhe ekskluzivisht dedikohen në sferën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime tjera që ju kthehen qytetarëve (tatim paguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës komunale.

Të Hyrat e Komunës përbëhen nga:

- Tatimi në pronë
- Tatimi në tokë
- Taksa për automjete motorike
- Taksa administrative komunale
- Taksa për leje ndërtimi
- Taksa për certifikata
- Qiraja nga objektet
- Bashkë-pagesat në arsim
- Bashkë-pagesat në shëndetësi
- Të hyra tjera¹ ♦

Figura 1: Buxheti Total i Komunës në vite , milion Euro:



Të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, kanë shënuar rritje të ndjeshme nga viti në vitë. Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2026, 589,728, në vitin 2027 planifikohe nga qendra në 591,853, në vitin do të jetë një planifikim normal. 2028, 606,119 dhe 2029 627,217 inkasimi i tarifave dhe ngarkesave të keti ligji që priten të inkasohen në vitet në vazhdim. Planifikimi i të hyrave në vitet në vazhdim është marë nga Qarkorja buxhetore 2027/1.

Kalkulimet e Tatimit në Pronë:

- *Vlera e Patundshmërisë* – sipas ndarjes së pronave në kategori zonave
- *Vlera e Kalkuluar Vjetore* - që duhet të mblidhet sipas vlerësimit të pronës (nëse supozojmë 100% pagesë sipas normave të përcaktuara me ligj)
- *Norma e Pagesës Vjetore* - Pagesat për vit, duke përjashtuar pagesat e borxhit, interesin dhe penaltitë, si përqindje e vlerës vjetore të kalkuluar
- *Borxhi i Akumuluar dhe Pagesa e Pritur e Borxhit*
- *Ndryshimet e pritura në normën e pagesës vjetore*

Kalkulimet e të hyrave tjera:

- Të gjitha të hyrat tjera vetanake të Komunave janë të hyra jo-tatimore (kryesisht taksa dhe pagesa tjera)
- Niveli i taksave dhe pagesave tjera vendoset nën principin e mbulueshmërisë së shpenzimeve të dedikuara për ofrimin e shërbimit komunal.
- Parashikimi i këtyre të hyrave duhet të bëhet duke parashikuar volumin e shërbimeve të ofruara

Tabela 2 PARASHIKIMI I TE HYRAVE VETANAKE SIPAS VITEVE 2026-2027-2028

Nr.	Përshkrimi	2026 Plani	2027 Vlerësimi	2028 Vlerësimi	2029 Vlerësimi
a	b	e	e	f	g
1	TË HYRAT KOMUNALE TOTALE	589,728	591,853	606,119	627,217
1.1	TË HYRAT VETANAKE	589,728	591,853	606,119	627,217
1.1.1	Tatimi në pronë	272,299	292,041	294,961	296,436
1.1.2	Tatimi në toke	66,129	80,016	80,416	80,818
1.1.3	Taksat komunale	141,382	142,000	142,000	142,000
	Licencat dhe lejet (taxat e bizneseve)	20,000	20,000	20,000	20,000
	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	50,000	50,000	50,000	50,000
	Taksat e pajisjeve motorike	51,382	52,000	52,000	52,000
	Lejet për ndërtesa	10,000	10,000	10,000	10,000
	Taksat tjera komunale	10,000	10,000	10,000	10,000
1.1.4	Ngarkesat komunale	20,000	20,000	20,000	20,000
	Ngarkesat regullatore				
	Të hyrat nga qiraja	20,000	20,000	20,000	20,000
	Bashkë-pagesat për arsim				
	Bashkë-pagesat për shëndetësi				
	Ngarkesat tjera komunale (gjobat)				
1.1.5	Të hyrat tjera	89,918	57,796	68,742	87,963
1.1.6	Shitja e aseteve				
1.1.7	Grantet dhe donacionet	0	0	0	0
	Vendore				
	Të huaja				
1.2	TRANSFERET QEVERITARE	0	0	0	0
1.2.1	Granti i përgjithshëm	0	0	0	0
1.2.2	Granti specifik për arsim	0	0	0	0
1.2.3	Granti specifik për shëndetësi	0	0	0	0
1.2.4	Grantet dhe transferet tjera	0	0	0	0

LIMITET FILLESTARE SIPAS QARKORES BUXHETORE Nr.2027/01NGA MEF-i:

	2026	2027	2028	2029
Granti për administratën Komunale	7,272,043	8,689,544	8,550,051	9,468,480
Granti për Arsim	3,766,347	2,983,845	3,073,361	3,165,561
Granti për Shëndetsi	1,626,763	1,778,228	1,831,575	1,886,522
Gjithsej granti nga BKK	12,665,153	13,451,617	13,454,987	14,520,563
Të hyrat vetanake nga Buxheti i KK-Dragashit	589,728	591,853	606,119	627,217
Totali i buxhetit Komunal-Dragashit	13,254,881	14,043,470	14,061,106	15,147,780

Nga përmbledhja e shpenzimeve për KK- të Dragashit shihet se për vitin 2027 janë planifikuar shpenzime prej 14,043,470 euro, sipas qarkores së parë 2027/ 01 nga MFPT-i.

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktuale të vitit 2026, planifikimi për vitin e ardhshëm 2027 si dhe projeksionet e vitit 2028-2029 janë gati të njëjta pos pagave dhe medityje, shpenzimeve kapitale dhe subvencionve.

3.4 Tabela 7: Shpenzimet Komunale 2026 (këtë vit), të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Drejtoritë/Programet	2026 (këtë vitë)					
	Paga Meditje	Mallra Sherbime	Shpenzime Komunali	Subvencione	Investimet Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetari	185,698	20,000		110,000		315,698
Zyra e Kuvendit Komunal	221,850	20,000				241,850
Administrata dhe Personeli	337,026	300,000				637,026
Çështje Gjinore	9,730	3,000				12,730
Buxhet dhe Financa	166,695	90,000				256,695
Sherbimet Publike	196,572	60,000	300,000			556,572
Zyra Komunale për Komunitet	46,503	12,000				58,503
Bujqësi, Pylltari, inspekcion dhe Zhvillim Rural	108,521	20,000		100,000		228,521
Kadastra dhe Gjeodezia	67,783	6,000				73,783
Planifikimi Urban dhe Mjedis	129,857	88,178			3,542,967	3,761,002
<u>Shëndetësi dhe mirqënia sociale</u>	1,228,588	382,197	52,800		40,000	1,703,585
Administrata	26,822	10,000				36,822
Shërbimet e Shëndetësis Primare	1,201,766	372,197	52,800		40,000	1,666,763
Sherbimet Sociale	87,925	10,000	3,000			100,925
Kulturë, Rini dhe Sport	134,637	20,000		130,000	246,851	531,488
<u>Arsim dhe shkencë</u>	4,104,437	481,967	44,200		85,900	4,776,504
Administrata	74,437	137,000		60,000		271,437
Arsim i parashkollor	446,439					446,439
Arsimi Fillor	2,993,530	264,967	36,200		85,900	3,380,597
Arsimi i Mesem	590,031	80,000	8,000			678,031
GJITHSEJ	7,025,822	1,513,342	400,000	400,000	3,915,718	13,254,882

Tabela 8: Shpenzimet Komunale për (vitin e 1) 2027, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/ Programet code	Nr: pun.	Pagat	Mallra dhe Sherbime	Shpenzime Komunale	Subvencione	Investimet Kapitale	Gjithësejt
Zyra e Kryetari	16009	14	186,698	20,000		201,853		408,551
Zyra e Kuvendit Komunal	16909	21	244,657	20,000				264,657
Administrata dhe Personeli	16309	40	338,026	500,000				838,026
Çështje Gjinore	16509	1	10,000	3,000				13,000
Buxhet dhe Financa	17509	18	168,695	90,000				258,695
Sherbimet Publike	18413	21	200,000	80,000	300,000			580,000
Zyra Komunale për Komunitet	19545	5	46,503	12,000				58,503
Bujqësi, Pylltari, inspektion dhe Zhvillim Rural	47009	11	108,521	20,000		150,000		278,521
Kadastra dhe Gjeodezia	65045	8	67,783	6,000				73,783
Planifikimi Urban dhe Mjedis	66350	12	129,857	171,076			3,497,724	3,798,657
<u>Shëndetësi dhe mirqënia sociale</u>	730	135	1,382,950	379,300	52,800		40,000	1,855,050
Administrata	73018	3	26,822	10,000				36,822
Shërbimet e Shëndetësis Primare	73550	132	1,356,128	369,300	52,800		40,000	1,818,228
Sherbimet Sociale	75541	10	87,925	10,000	3,000			100,925
Kulturë, Rini, Sport	85009	15	137,637	20,000		180,000	183,000	520,637
<u>Arsim dhe shkencë</u>	920	459	4,120,876	681,967	44,200		87,423	4,994,466
Administrata	92045	8	74,437	337,000		60,000		471,437
Arsimi parashkollor	92370	42	446,439					446,439
Arsimi fillor	93240	343	3,000,000	264,967	36,200		87,423	3,388,590
Arsimi i mesem	94441	66	600,000	80,000	8,000			688,000
Gjithësejt		770	7,230,128	2,013,343	400,000	591,853	3,808,147	14,043,470

Tabela 9: Shpenzimet Komunale, projeksionet 2028 (vitin e 2), të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Drejtoritë/Programet	Drejtorit ë/ Program et code	Nr: pu n.	Pagat	Mallra dhe Sherbime	Shpenzime Komunale	Subvenci one	Investime t Kapitale	Gjithësejt
Zyra e Kryetari	16009	14	186,698	20,000		201,853		408,551
Zyra e Kuvendit Komunal	16909	21	244,657	20,000				264,657
Administrata dhe Personeli	16309	40	338,026	500,000				838,026
Çështje Gjimore	16509	1	10,000	3,000				13,000
Buxhe dhe Financa	17509	18	168,695	90,000				258,695
Sherbimet Publike	18413	21	200,000	80,000	300,000			580,000
Zyra Komunale për Komunitet	19545	5	46,503	12,000				58,503
Bujqësi,Pylltari,inspek cion dhe hvillim Rural	47009	11	108,521	20,000		150,000		278,521
Kadastra dhe Gjeodezia	65045	8	67,783	6,000				73,783
Planifikimi Urban dheMjedis	66350	12	129,857	171,076			3,685,782	3,986,715
<u>Shëndetësi dhe mirqënia sociale</u>	730	135	1,402,950	379,300	52,800		20,000	1,855,050
Administrata	73018	3	26,822	10,000				36,822
Shërbimet e Shëndetësis Primare	73550	132	1,376,128	369,300	52,800		20,000	1,818,228
Sherbimet Sociale	75541	10	87,925	10,000	3,000			100,925
Kulturë, Rini, Sport	85009	15	87,925	10,000	3,000			100,925
<u>Arsim dhe shkencë</u>	920	459	4,220,876	681,967	44,200		100,000	5,107,043
Administrata	92045	8	74,437	337,000		60,000		471,437
Arsimi parashkollor	92370	42	446,439					446,439
Arsimi fillor	93240	343	3,000,000	264,967	36,200		100,000	3,401,167
Arsimi i mesem	94441	66	700,000	80,000	8,000			788,000
Gjithësejt		770	7,350,128	2,013,343	400,000	591,853	3,705,782	14,061,106

Tabela 10: Shpenzimet Komunale, projeksionet 2029 (vitin e 3), të shpërndara në kategori ekonomik dhe programe

Drejtoria/Programet	Drejtoria/ Programet code	Nr: pu n.	Pagat	Mallra dhe Sherbime	Shpenzime Komunale	Subvenci one	Investime t Kapitale	Gjithësejt
Zyra e Kryetari	16009	14	186,698	20,000		201,853		408,551
Zyra e Kuvendit Komunal	16909	21	244,657	20,000				264,657
Administrata dhe Personeli	16309	40	338,026	500,000				838,026
Çështje Gjimore	16509	1	10,000	3,000				13,000
Buxhe dhe Financa	17509	18	168,695	90,000				258,695
Sherbimet Publike	18413	21	200,000	80,000	300,000			580,000
Zyra Komunale për Komunitet	19545	5	46,503	12,000				58,503
Bujqësi,Pylltari,inspek cion dhe hvillim Rural	47009	11	108,521	20,000		150,000		278,521
Kadastra dhe Gjeodezia	65045	8	67,783	6,000				73,783
Planifikimi Urban dheMjedis	66350	12	129,857	171,076			4,114,163	4,415,096
<u>Shëndetësi dhe mirqënia sociale</u>	730	135	1,491,244	379,300	52,800		40,000	1,963,344
Administrata	73018	3	26,822	10,000				36,822
Shërbimet e Shëndetësis Primare	73550	132	1,464,422	369,300	52,800		40,000	1,926,522
Sherbimet Sociale	75541	10	87,925	10,000	3,000		250,000	350,925
Kulturë, Rini, Sport	85009	15	137,637	20,000		180,000	100,000	437,637
<u>Arsim dhe shkencë</u>	920	459	4,220,876	681,967	44,200		200,000	5,207,043
Administrata	92045	8	74,437	337,000		60,000		471,437
Arsimi parashkollor	92370	42	446,439					446,439
Arsimi fillor	93240	343	3,000,000	264,967	36,200		200,000	3,501,167
Arsimi i mesem	94441	66	700,000	80,000	8,000			788,000
Gjithësejt		770	7,438,422	2,013,343	400,000	591,853	4,704,163	15,147,780

PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)

Programi komunal për Investime publike përfshinë të gjitha projektet e aprovuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitin 2027-2029, nga ana e Kuvendit Komunal të Dragashit sipas proceseve buxhetore të zhvilluara dhe të aprovuara .

Në tabelën e më poshtme paraqesim listën e projekteve kapitale të parapara me buxhet të vitit 2026 me financim nga të hyrat vetanake si dhe nga mjetet e Grantit të destinuara për shpenzime kapitale .

Gjithashtu në këtë tabelë do të paraqesim edhe projektet e planifikuara për vitin fiskal 2027-2029, nga të hyrat vetanake të parashikuara si dhe nga mjetet e Grantit për shpenzime kapitale.

Kjo listë e planifikuar për vitin 2027-2029 mund të plotësohet edhe me projekte të tjera por edhe mund të largohen disa nga planifikimi, por ky plotësim dhe modifikim i projekteve mbetet për më vonë. Këto plotësime dhe modifikime mund të bëhen nga drejtoritë përkatëse gjatë shqyrtimeve për prioritet të Investimeve Kapitale si dhe gjatë diskutimeve me Komitetin për politikë dhe financa si dhe me struktura tjera Komunale, por gjithashtu edhe në takimet me qytetarë.

KUVENDI I KOMUNËS – DRAGASH

01 Nr. 060/01-11872-1/26

Dt. 25.06.2026



Lista e Shpenzimeve Kapitale për vitin 2027-2029

Projektit sipas programeve-nëiprogrameve		Planifikimi për vitin 2027					Parashikimi	Parashikimi
Nr:	Planifikimi urban dhe mjedis	Granti	TV	Totali	2028	2029		
1	Rahabilitimi i rruges në hyrje të Qytezez së Dragashit	80,000.00		80,000.00				
2	Fondi Rezerv i Komunes Dragash	100,000.00		100,000.00	840,782.00	1,299,163.00		
3	Ndërtimi i trotuarve në qendër të qytezës së Dragashit	20,000.00		20,000.00				
4	Ndërtimi i kulmeve të ndërtësive në Qytezen e Dragashit	80,000.00		80,000.00	20,000.00	30,000.00		
5	Rahabilitimi i infrastrukurës rrugore dhe ndërtimi i kanalizimit të Lagjës e re në Qytezen e Dragashit	30,000.00		30,000.00	200,000.00	300,000.00		
6	Bashkfinacimi i projekteve me donator me MZHR dhe MAPL	80,000.00		80,000.00	100,000.00	100,000.00		
7	Asfaltimi i rrugës të Mahallës së Xhamisë në fshatin Zapluxhë	35,000.00		35,000.00	35,000.00	35,000.00		
8	Kubizimi i rrugëve të varrezat në fshatin Zapluxhë (mahallë rrenak mahallë tunqinë dhe mahallë të xhamijës)	160,000.00		160,000.00	50,000.00	50,000.00		
9	Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e reja mahallë Tunqinë dhe ndërtimi i garazhës në fshatin Zapluxhë	20,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00		
10	Rehabilitimi i rrugës Presllap dhe kroi I Ftohet, Ndrim i gypit të ujësjes së lagjes Hysenajve, dhe ndërtimi i kështjellës së lojërave në Qendër mahallë të Xhamisë në fshatin Zapluxhë	15,000.00		15,000.00	5,000.00	5,000.00		
11	Kubizimi i rrugëve të mahallës së Xhamisë dhe mahallës së Eperme në fshatin Blaq	20,000.00		20,000.00	50,000.00	50,000.00		
12	Asfaltimi i rrugës Blaq-Bjeshk dhe Blaq-Shtava në fshatin Blaq	80,000.00		80,000.00	100,000.00	100,000.00		
13	Kubizimi i rrugëve në fshatin Bresanë	135,000.00		135,000.00	100,000.00	100,000.00		
14	Ndërtimi i rrugës Begiraj - Shysllak, Rrafshina dhe ndërthyerja fshatit Bresanë	50,000.00		50,000.00	10,000.00	100,000.00		
15	Ndërtimi i rrugës Rrafshina Mali i Madh në fshatin Bresanë	100,000.00		100,000.00	120,000.00	12,000.00		
16	Kubizimi dhe ndërtimi i Kanalit për ujërë atmosferike në rrugën Kuklibeg-Kuk në fshatin Kuklibeg dhe trasimin i rrugës fushorë për gjatë lrvadheve në Kuklibeg	45,000.00		45,000.00	10,000.00	100,000.00		
17	Ndërtimi i kanalizimit të rrugës së fushës në fshatin Kuk	30,000.00		30,000.00				
18	Hapja dhe trasimi dhe kubizimi i rrugës Kuk-Kosav	45,000.00		45,000.00	10,000.00	100,000.00		
19	Kubizimi në rrugën Qendra në fshatin Buzëz	60,100.00		60,100.00	20,000.00	20,000.00		
20	Ndërtimi i kanalizimit nga Shkollë Fillore deri tek impianti në fshatin Breznë	40,000.00		40,000.00				
21	Kubizimi i rrugëve lagjet kalander dhe mejin si dhe ndërtimi publik në fshatin Kosavë	60,000.00		60,000.00	60,000.00	60,000.00		
22	Rehabilitimi i rrjetit të Ujësjes së Kanalizimit në fshatin Kosavë dhe Hapja e rrugës për bjeshkë në fshatin Kosavë	15,000.00		15,000.00	10,000.00	10,000.00		
23	Ndërtimi i rrugës Xerxë-Rrenc	30,000.00		30,000.00	20,000.00	20,000.00		
24	Kubizimi i rrugëve në fshatin Zgatar	45,000.00		45,000.00	20,000.00	20,000.00		

25	Kubëzimi i rrugës prejë daljes së fshatit deri të lapidari dhe ndertimi i rruges deri te kroi i Usharit në fshatin Brutt	84,368.00		84,368.00	20,000.00	20,000.00
26	Ndertimi i rezervarit ujti mbi Zabel, shtrimi i rjetit si dhe kubzimi i rrugëve të Sharra dhe Smonica ne fshatin Bellobrad	118,783.00		118,783.00		
27	Kubezimi i rrugëve ne fshatin Zym	44,183.00		44,183.00	20,000.00	20,000.00
28	Kubzimi i rrugëve në rrugët Adem Berisha, Beteja e Buges dhe Qerza në fshatin Buge	74,000.00		74,000.00	20,000.00	200,000.00
29	Rehabilitimi i rrugëve lokale në rajonin e Opojes	110,000.00		110,000.00	150,000.00	200,000.00
30	Ndertimi i murit mbrojtës te varrezat dhe Kubezimi ne fshatin Rrenc	115,000.00		115,000.00	20,000.00	23,000.00
31	Rehabilitimi i rruges Rumenica, bjeshkes si dhe kubezimi i rrugëve ne fshatin Shajne	40,000.00		40,000.00	40,000.00	40,000.00
32	Ndertimi i rruges se fushes në fshatin Pllajnik	40,000.00		40,000.00	40,000.00	40,000.00
33	Ndertimi i kendit te lojta per Femi ne oborin e shkollen fshati Shajnes	20,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00
34	Kubzimi i rrugëve në fshatin Pllav	85,000.00		85,000.00	35,000.00	35,000.00
35	Kubzimi i rrugëve në fshatin Kapre	45,000.00		45,000.00	45,000.00	45,000.00
36	Ndërtimi i stadiomit në Krevceices në fshatin Pllav	160,000.00		160,000.00	20,000.00	200,000.00
37	Renovimi i objekteve të administratës ne fshatrat e Gores	20,000.00		20,000.00	9,000.00	
38	Ndertimi i rjetit të ujellit ujellit ne gender të fshatin Brod	13,870.00		13,870.00	10,000.00	14,000.00
39	Ndertimi i parkingut dhe hapja e rruges Jamke në fshatin Dikanc	30,000.00		30,000.00	30,000.00	30,000.00
40	Ndërtimi i parkingut dhe infrastrukturës ne vendin Ravniste në fshatin Baqk	40,000.00		40,000.00	30,000.00	40,000.00
41	Rehabilitimi i rruges asfaltike ne fshatin Zlipotoka	15,000.00		15,000.00	50,000.00	50,000.00
42	Ndertimi i murit mbrojtës ne vendi Peterce, kubzimi i rrugëve në gender dhe vendosja e pahjve elastike në hyrje të fshatit Radesh	88,435.00		88,435.00	80,000.00	
43	Ndertimi i ifastruktures rrugore ne vendin Studenec dhe Befridec fshatit Kerstec	60,000.00		60,000.00	60,000.00	60,000.00
44	Ndertimi i muzeut në Qender të fshatit Brod	60,000.00		60,000.00	10,000.00	50,000.00
45	Kubzimi i rrugëve,ndërtimi i kanalizimit dhe ndertimi i parkut per lojrat e fëmijve në Qender të fshatit Vraniç	50,000.00		50,000.00	50,000.00	50,000.00
46	Regullimi i perroit me infrastrukture perçjellëse ne fshatin Rapce	80,000.00		80,000.00	80,000.00	
47	Ndertimi i murit dhe kubzimi i rrugëve në Qender të fshatin Orqusha	30,000.00		30,000.00	30,000.00	
48	Kubëzimi i rrugëve dhe infrastrukture perçjellëse në Qender të fshatit Zlipotok	35,000.00		35,000.00		
49	Kubzimi i rrugëve dhe ndertimi i kendit të lojtrave per fëmijë	40,000.00		40,000.00	40,000.00	
50	Regullimi i infrastrukturës fshatare dhe ndërtimi i këndit të lojtrave për fëmijë	40,000.00		40,000.00	40,000.00	
51	Ndërtimi i murit mbrojtës dhe kubëzimi i rrugëve në Qender të fshatit Gllloboçicë	100,000.00		100,000.00	100,000.00	40,000.00
52	Ndertimi mureve mbajtëse dhe mbrojtëse me infstranukturën pëçjellëse nëfshati Krushev	60,000.00		60,000.00	80,000.00	50,000.00
53	Kubzimi i rrugëve dhe infrastruktura perçjellëse ne fshatit Restelic	199,317.00		199,317.00	250,000.00	200,000.00
54	Regullimi i rruges dhe infrastruktur perçjellëse në rrugen Qupino në fshatin Brod	90,000.00		90,000.00	160,000.00	90,000.00
55	Regullimi i perroit dhe rehabilitimi i rruges me infrastrukture perçjellëse ne Lagjen e re të Dragash	45,000.00		45,000.00	46,000.00	46,000.00

56	Ndërtimi i shtëpis malore në vendin Prekoreka në fshatin Krushev	39,668.00		39,668.00	20,000.00	20,000.00
57	Hapja e rruges dhe kubzimi i rrugore ne fshatin Lubovisht	50,000.00		50,000.00	40,000.00	
	<i>Sherbimet e shëndetësisë primare</i>					
1	Renovimi i QMF dhe AMF në fshatrat e Gores Restelic,Brod,Rapq,Vraniq,Radesh	40,000.00		40,000.00	20,000.00	40,000.00
	<i>Sherbimet Sociale dhe Rezidenciale</i>					
1	Ndërtimi i shtëpipe për personat me aftësi të kufizuar në Komunë e Dragashit					250,000.00
	<i>Kulture Rini Sport</i>					
1	Ndërtimi i stadiionit në fshatin Blac	143,000.00		143,000.00	100,000.00	100,000.00
2	Ndërtimi i stadiumit per futboll te vogel ne fshatin Mlike	40,000.00		40,000.00	40,000.00	
	<i>Arsimi dhe Shkencë</i>					
1	Renovimi i shkolles fillore Ilmi Bahitjari në fshatin Blac	17,423.00		17,423.00	30,000.00	30,000
2	Renovimi i objekteve të administratës ne fshatrat e Gores	70,000.00		70,000.00	70,000	170,000.00
	TOTALI	3,808,147	0	3,808,147	3,705,782	4,704,163

KUVENDI I KOMUNËS – DRAGASH
01 Nr. 069/01-11832-1/26
Dt. 25.06.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Resul Fetahu

